

VENDIMI TEKNIK Nr. 1-T

“Procedura për Pranimin në Bursë të Anëtarit të Bursës, Dorëheqjes së tij dhe çështje të tjera në lidhje me Anëtarët e Bursës në Tregjet e ALPEX-it”

Në mbështetje të dispozitave të përcaktuara Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme, konkretisht në paragrafin A.1.1.2 pika c), Seksionet C.1.2, C.2.3 dhe F.4.2, siç janë në fuqi:

ALPEX sh.a miratoi:

1. Vendimin Teknik – Procedura për Pranimin e Anëtarit të Bursës, Dorëheqjes së tij dhe çështje të tjera në lidhje me Anëtarët e Bursës në Tregjet e ALPEX-it.
2. Vendimi Teknik Nr. 1-T i paraqitet për njoftim Entit Rregullator të Energjisë - ERE dhe Zyrës së Rregullatorit për Energji - ZRrE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ADMINISTRATORI I ALPEX SH.A

Sokol Dishnica

Neni 1

Objekti- Fushëveprimi- Përkufizimet

Ky Vendim Teknik përcakton çështjet e mëposhtme në lidhje me Anëtarët e Bursës në Tregjet e ALPEX-it:

- (a) procesin e Pranimi si Anëtar i Bursës;
- (b) procesin lidhur me Dorëheqjen e Anëtarit të Bursës;
- (c) procesin lidhur me rastet e transformimeve korporative të një Anëtari të Bursës; dhe
- (d) procesin e aplikueshëm në rastet e rivendosjes së Infrastrukturës të Teknologjisë së Informacionit të Anëtarit të Bursës.

Përkufizimet e këtij Vendimi Teknik kanë të njëjtin kuptim me ato të parashikuara në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Përkufizimet ose Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat, dhe në legjislacionin përkatës lidhur me tregjet e energjisë elektrike.

Neni 2

Procedura e Pranimi në Bursë

2.1 Procesi dhe Fazat e nevojshme për pranimin si një Anëtar Burse në ALPEX

- (a) Për tu pranuar në Bursë, Aplikanti duhet të përfundojë me sukses procedurën e parashikuar në këtë Nen. I gjithë procesi përfshin tre (3) faza individuale, si vijon:
 - (i) vlerësimi i Aplikimit për Anëtarësim, ndjekur nga Vendimi përkatës
 - (ii) përgatitja për aktivizimin e Anëtarit të Bursës në ETSS, dhe
 - (iii) aktivizimi i Anëtarit të Bursës në ETSS.
- (b) ALPEX-i do të asistojë Aplikantin gjatë procesit të Aplikimit për Anëtarësim dhe nënshkrimit të Marrëveshjes së Anëtarësimit në Bursë. Pjesëmarrja në çdo fazë pasuese të procesit kërkon përfundimin me sukses të fazës pararendëse.

2.1.1 Faza e parë: Vlerësimi i Aplikimit për Anëtarësim, ndjekur nga Vendimi përkatës.

Kjo fazë lidhet me procesin e vlerësimit të Aplikimit për Anëtarësim dhe nënshkrimin e Marrëveshjes së Anëtarësimit në Bursë, ndërmjet ALPEX-it dhe Aplikantit, me kusht përmbushjen e të gjitha kërkesave të mëposhtme.

2.1.1.1 Kushtet e përgjithshme

- (a) Aplikanti plotëson dhe dorëzon Aplikimin për Anëtarësim, i cili është një formular standard i siguruar nga ALPEX-i. Aplikimi për Anëtarësim do të

shoqërohet nga një formular standard “Si të njohësh klientin tënd” (Know your client).

- (b) Aplikimi për Anëtarësim do të shoqërohet nga i gjithë informacioni dhe dokumentet mbështetëse, siç parashikohet në këtë Vendim Teknik.
- (c) Të gjitha dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen në shqip ose anglisht dhe duhet të mbajnë vulën e kompanisë, sipas rastit përkatës. Një listë me dokumentet mbështetëse do ti sigurohet Aplikantit nga ALPEX-i, dhe do të përcaktojë se cilat dokumente duhet të paraqiten në kopje ose origjinal/kopje të noterizuara nga origjinali.
- (d) Gjatë vlerësimit të informacionit të mëposhtëm, si dhe dokumentacionit mbështetës lidhur me të dhënat e Aplikantit, ALPEX-i mund të kërkojë dokumente/informacion plotësues në këtë fazë, si vijon, nëse ALPEX-i nuk është i kënaqur.

2.1.1.2 Entitetet e pranueshme

Nëse Aplikanti paraqet një Aplikim për Anëtarësim në ALPEX, ai vihet në dijeni të kërkesave të përcaktuara në seksionin C.1.1 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme, dhe duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme:

- (a) Ekstrakt të vlefshëm që është i regjistruar dhe është aktiv në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) në Shqipëri për zonën ofertuese të Shqipërisë ose Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK) për zonën ofertuese të Kosovës.
- (b) Licenca/Akti i njohjes lëshuar nga Enti Rregullator i Energjisë / Zyra e Rregullatorit të Energjisë i vendit të origjinës (ose përjashtimet apo derogimet nga detyrimi për të pasur një licencë apo akt të tillë) për tregtimin e energjisë elektrike (ku është e aplikueshme), sipas rastit, siç kërkohet nga Ligji në fuqi.
- (c) Vërtetim që është Palë Përgjegjëse për Balancim apo që është pjesë e Grupit të Palës Përgjegjëse për Balancim, të konfirmuar nga OST / KOSTT, sipas rastit.
- (d) Dëshminë që është i regjistruar pranë Entit Rregullator të Energjisë / Zyrës së Rregullatorit të Energjisë përkatës sipas Rregullores REMIT, sipas rastit;
- (e) Të sigurojë ALPEX-in që do të ketë aftësinë teknike për të tregtuar në Platformat e ALPEX-it.
- (f) Të deklarojë nëse do të jetë Anëtar Personal i Klerimit (pas skadimit të përjashtimit) apo të dorëzojë një deklaratë për bashkëpunimin e tij me një Anëtar të Përgjithshëm Klerimi të ALPEX-it në lidhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes.
- (g) Vërtetim që ka paguar Tarifën Fikse Administrative, sipas Listës së Tarifave të ALPEX-it, publikuar në faqen zyrtare të internetit të ALPEX-it.
- (h) Pas përmbushjes së kërkesave nga (a) deri në (g), nëse ALPEX vlerëson se nevojiten informacione ose sqarime të mëtejshme, do t’i dërgojë një njoftim Aplikantit, për të dhënë këtë informacion apo sqarim. Nëse ky informacion i

kërkuar nuk i jepet ALPEX-it brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, do të konsiderohet se Aplikimi për Anëtarësim është tërhequr.

2.1.1.3 Procesi i Pranimit

Pas plotësimit me sukses të kërkesave të 2.1.1.2, ALPEX-i do t'i kërkojë Aplikantit të dorëzojë dokumentet e mëposhtme për vlerësim të mëtejshëm, në lidhje me vlerësimin e kapaciteteve ligjore, teknike dhe ekonomike të Aplikantit:

- (a) Statutin e shoqërisë
- (b) Dëshmi nga Gjykata dhe Prokuroria (të lëshuar jo më vonë se 30 ditë), se shoqëria nuk është në proces falimentimi ose ndonjë proces tjetër penal ose është dënuar për veprat penale të mëposhtme:
 - i. mashtrim, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi,
 - ii. pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
 - iii. falsifikim.

Për zonën ofertuese të Kosovës kërkohet vetëm dëshmia nga Gjykata, sipas kushteve të sipërpërmendura, në përputhje me kërkesat e Legjislacionit në fuqi.

- (c) Dëshmi nga Gjykata dhe Prokuroria (të lëshuar jo më vonë se 30 ditë), se Administratori/Drejtori Menaxhues i shoqërisë nuk është në proces ose nuk është dënuar për veprat penale të mëposhtme:
 - i. pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
 - ii. korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
 - iii. mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
 - iv. pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
 - v. vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
 - vi. falsifikim;
 - vii. puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Për zonën ofertuese të Kosovës kërkohet vetëm dëshmia nga Gjykata, sipas kushteve të sipërpërmendura, në përputhje me kërkesat e Legjislacionit në fuqi.

- (d) Vetë deklaram ku tregon Bursat e Energjisë ku shoqëria është apo ka qenë e regjistruar.
- (e) Pasqyrat financiare të Aplikantit për 3 (tre) vitet e fundit. Nëse Aplikanti është themeluar brenda 3 (tre) viteve të fundit, ai duhet të dorëzojë të gjitha pasqyrat financiare që disponon.
- (f) Aplikanti do të informojë ALPEX-in në lidhje me infrastrukturën organizative, operacionale dhe tekniko-ekonomike, si dhe mekanizmat e duhur dhe të përshtatshëm të kontrollit dhe sigurisë për përpunimin elektronik

të të dhënave dhe procedurat e kontrollit të brendshëm, në lidhje me pjesëmarrjen e tij në Tregjet e ALPEX-it.

- (g) Nëse Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST), Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Operatori i Burimeve të Rinovueshme të Energjisë, Kompanitë Publike të Gjenerimit dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal nuk do të veprojnë si Anëtar Personal i Klerimit ata kanë të drejtë të paraqesin vetëm dokumentet e përcaktuara në paragrafin 2.1.1.1 (a), dokumentet e përcaktuara në paragrafin 2.1.1.2 (a) dhe (f) dhe dokumentet e përcaktuara në paragrafin 2.1.1.3 (a) dhe (f). Në rast se këto kompani do të vendosin të veprojnë si Anëtar i Përgjithshëm i Klerimit, atëherë ato janë të detyruara të përmbushin të gjitha dispozitat e përcaktuara në paragrafin 2.1.1.3 (e).
- (h) Nëse Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), Operatori i Burimeve të Rinovueshme të Energjisë dhe Kompanitë Publike të Gjenerimit nuk do të veprojnë si Anëtar Personal i Klerimit ata kanë të drejtë të paraqesin vetëm dokumentet e përcaktuara në paragrafin 2.1.1.1 (a), dokumentet e përcaktuara në paragrafin 2.1.1.2 (a) dhe (f) dhe dokumentet e përcaktuara në paragrafin 2.1.1.3 (a) dhe (f). Në rast se këto kompani do të vendosin të veprojnë si Anëtar i Përgjithshëm i Klerimit, atëherë ato janë të detyruara të përmbushin të gjitha dispozitat e përcaktuara në paragrafin 2.1.1.3 (e).

Me dorëzimin e gjithë dokumentacionit të mësipërm, ALPEX-i do të bëjë vlerësimet e nevojshme të Aplikimit. Nëse Aplikanti përmbush kërkesat e këtij Vendimi Teknik, ALPEX-i do të lëshojë një Njoftim për Pranimin, i cili lejon Aplikantin të vazhdojë procedurat për nënshkrimin e Marrëveshjes së Anëtarësimit në Bursë, përveç rasteve kur Aplikanti ka për qëllim të bëhet Anëtar Personal i Klerimit. Në këtë rast, procesi i nënshkrimit të Marrëveshjes së Anëtarësimit në Bursë duhet të bëhet në të njëjtën kohë me procesin e nënshkrimit të Marrëveshjes Kuadër për Klerim. Aplikanti do t'i dërgojë Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë të nënshkruar ALPEX-it brenda 30 (tridhjetë) Ditëve. Nëse rastin kur aplikanti nuk dërgon pranë ALPEX-it Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë të nënshkruar brenda këtij afati kohor të përcaktuar, do të konsiderohet se aplikimi për anëtarësim është tërhequr dhe aplikanti duhet të përsërisë të gjithë fazën e parë (dokumentet dhe tarifat e përcaktuara), në rastin kur dëshiron të vijojë me anëtarësimin në Bursë.

Nëse ALPEX është i kënaqur që Marrëveshja e Anëtarësimit në Bursë është ekzekutuar siç duhet nga Aplikanti dhe Tarifa Fikse e Anëtarësimit është paguar dhe të gjitha kushtet e specifikuar janë plotësuar, atëherë ALPEX-i do të njoftojë Anëtarin e Bursës me shkrim për Datën e Hyrjes në Fuqi të anëtarësimit të tij.

2.1.2 Faza e dytë: Përgatitja për aktivizimin e Anëtarit të Bursës në ETSS.

Faza e dytë fillon në Ditën pasardhëse të hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Anëtarësimit në Bursë.

Anëtari i Bursës duhet të kryejë të gjitha hapat vijues përsa i përket aktivizimit në ETSS:

- (a) Anëtari i Bursës duhet të ketë Infrastrukturën e Teknologjisë së Informacionit së nevojshme për të siguruar lidhjen e suksesshme me Sistemin Elektronik të

Tregtimit në Çast (ETSS) të ALPEX-it, në përputhje me parashikimet e këtij Vendimi Teknik dhe Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat, jo më vonë se 30 (tridhjetë) Ditë.

- (b) Duhet të caktojë një numër të mjaftueshëm të Agjentëve Tregtar të tij (në bazë të gjykimit të tij, pa rrezikuar kërkesat e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat, për t'u trajnuar dhe certifikuar nga ALPEX-i, jo më vonë se 10 (dhjetë) Ditë.
- (c) Në mënyrë që të kontrollojë gatishmërinë e Anëtarit të Bursës dhe Agjentëve Tregtar të Certifikuar të tij, ALPEX-i do të kërkojë pjesëmarrjen në sesionet prove të testeve të tregtimit ose në skenarë të tjerë simulimi të kushteve aktuale të tregtimit ose shlyerjes.
- (d) Agjentët Tregtar të Certifikuar prej ALPEX-it do të plotësojnë formularin e lëshimit të Certifikatave të Tregtimit dhe Trajnimit, i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare të internetit të ALPEX-it. Ky formular mundëson lëshimin e certifikatave përkatëse për agjentët tregtare të certifikuar nga ALPEX-i.

Nëse Anëtari i Bursës nuk do të respektojë afatet e mësipërme kohore, kërkesa e tij do të refuzohet për mos përfundimin e fazës së dytë. Anëtari i Bursës do të ri paraqesë Aplikimin për Anëtarësim nëse synon të vazhdojë pranimin e tij në Bursë. Çdo tërheqje në këtë fazë nga Anëtari i Bursës nuk do të përbëjë rimburesim të Tarifës Fikse së Anëtarësimit.

Nëse dokumentacioni/veprimet e kërkuara dorëzohen brenda afatit kohor të parashikuar dhe kënaqin ALPEX-in, kjo fazë do të konsiderohet e përfunduar me sukses dhe Anëtari i Bursës do të njoftohet sipas rrethanave.

2.1.3 Faza e tretë: Aktivizimi i Anëtarit të Bursës në Sistemin e Tregtimit të Energjisë në Çast (ETSS)

- (a) Fillimisht, Anëtari i Bursës duhet ti paguajë ALPEX-it Tarifën Fikse Vjetore sipas Listës së Tarifave të ALPEX-it, të publikuara në faqen zyrtare të internetit të ALPEX-it.
- (b) Pasi Anëtari i Bursës të përfundojë me sukses veprimet e përshkruara në fazat e mësipërme dhe paragrafin 2.1.3 (a), duhet të dorëzojë formularët standarde të plotësuar në përputhje me procedurat e mëposhtme, të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të internetit të ALPEX.
 - (i) Aplikimi – Marrëveshje për Certifikatën e Verifikimit të Klientit (Client Authentication Certificate) në sistemet e ALPEX-it.

Anëtari i Bursës plotëson të paktën 1 (një) aplikim për Certifikatën e Verifikimit të Klientit, nëpërmjet Agjentit të tij Tregtar të Certifikuar. Kjo është një certifikatë që mundëson identifikimin e klientit në Platformën e ALPEX dhe lëshohet nga Ofruesi i Shërbimit të ALPEX për një periudhë kohore 1 (një) vjeçare. Kostot e kësaj certifikate janë të përcaktuara sipas tarifës përkatëse të publikuar në Listën e Tarifave në faqen zyrtare të internetit të ALPEX. Lëshimi i kësaj certifikate do të bëhet vetëm pas pagesës së tarifës së saj, sipas udhëzimeve të ALPEX. Vetëm pas kryerjes së pagesës përkatëse për këtë Certifikatë do të vijohet me plotësimin

e dokumentacionit të nevojshëm për plotësimin e fazës së tretë të Anëtarësimit në ALPEX.

(ii) Formulari i Aktivizimit

Me këtë formular, Anëtari i Bursës duhet të përmendë datat në të cilat dëshiron të aktivizohet:

- në Tregun e Ditës në Avancë, dhe/ose
- në Tregun Brenda të Njëjtës Ditë (kur të jetë i aplikueshëm)

(iii) Formulari i Lidhjes me Sistemin e Tregtimit të Energjisë në Çast (ETSS)

Me këtë formular, Anëtari i Bursës kërkon caktimin/fshirjen e përdoruesve, si dhe fillimin/mbarimin/modifikimin e lidhjes me ETSS.

(iv) Formulari i Profilit të Anëtarit

Më këtë formular, Anëtarit të Bursës i kërkohet të përcaktojë personat të cilët do të shërbejnë si persona kontakti për komunikimin midis Anëtarit të Bursës dhe ALPEX-it.

- (c) Veprimet e mësipërme duhet të përfundojnë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) Ditëve nga përfundimi i fazës së dytë.
- (d) Nëse Aplikanti do të veprojë si Anëtar Personal i Klerimit, aktivizimi i tij si Anëtar i Bursës do të kryhet pas aktivizimit të tij si Anëtar Personal i Klerimit.
- (e) Anëtari i Bursës i cili vepron si Anëtar Personal i Klerimit ka të drejtë të aksesojë sistemet e ALPEX-it në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes, siç kërkohet nga Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe vendimet e marra në përputhje me to.

2.2. Komunikimi me ALPEX-in lidhur me këtë Vendim Teknik.

Aplikanti mund të dorëzojë dokumentet e kërkuara fillimisht me email (kopje e skanuar e origjinalit apo të noterizuara) për t'u vlerësuar nga ALPEX-i. Në çdo rast, Aplikanti duhet të dorëzojë kopjen ose origjinalin/kopjen e noterizuar të origjinalit në "hard copy", përpara se të nënshkruhet Marrëveshja e Anëtarësimit në Bursë nga të dyja palët, siç përcaktohet në listën e dokumenteve të siguruar nga ALPEX. Ky komunikim nuk do të ndikojë në asnjë prej afateve kohore të lartpërmendura, të cilat janë të përcaktuara për çdo fazë.

Anëtarët e Bursës janë përgjegjës për plotësimin, korrektësinë dhe vërtetësinë e informacionit të dhënë ALPEX-it, i dhënë ky në origjinal ose i përditësuar në çdo kohë, si dhe duhet t'u përgjigjen menjëherë kërkesave të ALPEX-it.

Anëtari i Bursës është i detyruar të informojë menjëherë ALPEX-in, sipas kërkesave të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat, për çdo ndryshim në regjistrin e të dhënave të Anëtarit të Bursës. Deri në njoftimin e këtij ndryshimi, çdo dokument lidhur me detajet e kontaktit të dhëna nga Anëtari i Bursës në fazën e paraqitjes së Aplikimit, është ligjërisht efektiv.

Neni 3

Procedura lidhur me dorëheqjen nga statusi i Anëtarit të Bursës

- 3.1. Përveç specifikimeve të C.2.3, C.2.8 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme, për të përfunduar procesin e dorëheqjes, Anëtari i Bursës duhet të veprojë në përputhje me parashikimet si vijon:
- (a) Anëtari i Bursës i cili synon të japë dorëheqjen duhet të plotësojë një formular standard të dorëheqjes, të ofruar nga ALPEX-i.
 - (b) Në datën efektive të dorëheqjes së dhënë nga Anëtari i Bursës në formularin standard të dorëheqjes, ALPEX-i do të çaktivizojë Anëtarin e Bursës nga ETSS dhe nuk do ta lejojë Anëtarin e Bursës të vendosë porosi në ETSS për Ditën e Livrimit që korrespondon me datën efektive të dorëheqjes.
 - (c) Nga kërkesa për dorëheqje deri në Datën Efektive të dorëheqjes, Anëtari i Bursës duhet të përmbushë të gjitha detyrimet kundrejt ALPEX-it, sipas Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat.
 - (d) Nëse ALPEX-i nuk e pranon kërkesën e dorëheqjes, ALPEX-i do të japë një përgjigje të arsyetuar.
 - (e) Nëse ALPEX-i e pranon kërkesën e dorëheqjes, ALPEX-i do të njoftojë me shkrim Anëtarin e Bursës duke specifikuar kohën kur dorëheqja hyn në fuqi.

Neni 4

Transferimet korporative të Anëtarëve të Bursës

4.1. Përthithja e një Anëtari të Bursës nga një Anëtar tjetër i Bursës të ALPEX

Kushtet e parashikuara në par. (4.1) të këtij Neni zbatohen ekskluzivisht kur të dyja Palët, si subjekti ligjor i përthithur ashtu edhe subjekti ligjor që përthithet, janë Anëtarë të Bursës në ALPEX.

4.1.1. Veprimet e Anëtarit të përthithur të Bursës dhe Anëtarit përthithës të Bursës

- a) Në rast se një Anëtar i Bursës përthithet nga një Anëtar tjetër i Bursës, Anëtari përthithës i Bursës vazhdon të funksionojë si Anëtar i Bursës, dhe rrjedhimisht të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Anëtarit të Bursës të përthithur do ti kalojnë Anëtarit përthithës të Bursës.
- b) Anëtari i Bursës i përthithur dhe përthithës duhet të njoftojnë ALPEX-in 5 (pesë) ditë përpara ditës së hyrjes në fuqi të bashkimit. Me marrjen e këtij njoftimi, ALPEX-i do të zbatojë dispozitat e Pezullimit tek Anëtari i përthithur i Bursës, siç parashikohet në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme.
- c) Në çdo rast, pas hyrjes në fuqi të bashkimit, Anëtari i Bursës përthithës duhet të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga akviteti i Anëtarit të përthithur të Bursës në Tregjet e ALPEX-it, në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat, si dhe Vendimet Teknike. Çdo mos

përbushje e këtyre detyrimeve brenda afateve kohore të përcaktuara do të bëjë që Anëtari përthithës i Bursës të jetë në kushtet e Mos përbushjes së Detyrimeve.

- d) Me përfundimin e procedurës së lartpërmendur, ALPEX-i do të fillojë procesin e Përfundimit të Anëtarit të përthithur të Bursës, siç parashikohet në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme.

Anëtari përthithës i Bursës duhet të respektojë procedurat e mëposhtme:

4.1.1.1. Instalimi i infrastrukturës të teknologjisë së informacionit dhe aktivizimit në Sistemin e Tregimit të Energjisë Elektrike në Çast (ETSS)

Procedura e instalimit përfshin 3 (tre) faza:

Faza e parë

Së bashku me informacionin e përcaktuar në 4.1.1, b) të këtij Vendimi Teknik, Anëtari i Bursës të paktën dhjetë (10) ditë përpara kohës në të cilën Anëtari i Bursës deklaron se dëshiron të përdorë infrastrukturën ekzistuese të teknologjisë së informacionit të Anëtarit të përthithur të Bursës, për qëllimet e tij tregtare, do të dërgojë një letër informacioni të përditësuar ALPEX-it:

- (a) mbi planifikimin e çdo ndryshimi në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit
- (b) mbi hartimin e skedulit për zbatimin e veprimeve të mësipërme.

Faza e dytë

Së paku 5 (pesë) Ditë se të përdorë infrastrukturën e teknologjisë së informacionit të Anëtarit të përthithur të Bursës, Anëtari përthithës i Bursës duhet të dorëzojë ALPEX-it një kërkesë për zhvendosjen e infrastrukturës së re të teknologjisë të informacionit.

Faza e tretë

Infrastruktura e aksesit të Anëtarit të Bursës së përthithur do të akomodohet për përdorim nga Anëtari përthithës i Bursës, brenda një kohe të arsyeshme. Gjatë periudhës së tranzicionit, infrastruktura e aksesit e Anëtarit të përthithur të Bursës nuk mund të përdoret nga Anëtari përthithës i Bursës.

Për të përfunduar këtë fazë Anëtari i përthithur i Bursës duhet të sjellë një kopje të dokumentacionit të regjistrimit të shoqërisë në regjistrin përkatës tregtar, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Anëtari i përthithur i Bursës nuk po kryen aktivitet tregtar.

Pas përfundimit të Fazës së tretë, për Anëtarin e përthithur të Bursës ALPEX-i do të ndërmarrë veprimet e mëposhtme:

- (a) fshirjen e të gjithë përdoruesve të Anëtarit të përthithur të Bursës nga ETSS-ja dhe EMCS-ja.
- (b) fshirjen e të gjithë informacionit të anëtarit të përthithur të Bursës.

4.1.2 Dispozita kalimtare dhe përfundimtare

Kur procesi i bashkimit të ketë përfunduar, ALPEX-i menjëherë do të përditësojë bazën e të dhënave të Anëtarit të Bursës me adresën e re dhe detajet e reja të Anëtarit përthithës të Bursës, i cili ka rezultuar nga procesi i bashkimit.

Neni 5

Zhvendosja e infrastrukturës së teknologjisë të informacionit të një Anëtari të Bursës

Në rastin e zhvendosjes së teknologjisë së informacionit të një Anëtari të Bursës në një tjetër adresë, Anëtari i Bursës duhet të kryejë veprimet e mëposhtme.

5.1 Faza e parë

Të paktën 30 (tridhjetë) ditë para kohës së deklaruar nga Anëtari i Bursës, se ai dëshiron që informacioni i tij të funksionojë në një adresë të re, Anëtari i Bursës dërgon në ALPEX një letër informuese me detajet e ndryshuara të adresës:

- (a) mbi planifikimin e çdo ndryshimi në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit të Anëtarit të Bursës;
- (b) mbi hartimin e skedulit për zbatimin e veprimit të mësipërm.

5.2 Faza e dytë

Më së shumti 10 (dhjetë) ditë para kohës së deklaruar të funksionimit të infrastrukturës së teknologjisë të informacionit të Anëtarit të Bursës në adresën e re, Anëtari i Bursës duhet të ketë kryer përgatitjen e kërkuar teknike, sipas udhëzimeve të ALPEX-it.

5.3 Faza e tretë

Më së shumti 20 (njëzetë) ditë para kohës së deklaruar të funksionimit të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit në adresën e re, Anëtari i Bursës duhet të paraqesë në mënyrë elektronike në ALPEX formularin standard përkatës, i cili është i publikuar në faqen zyrtare të internetit të ALPEX-it lidhur me ndryshimet e Anëtarit të Bursës.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky Vendim Teknik hyn në fuqi më datë 07.09.2023.

Ky Vendim Teknik do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të ALPEX www.alpex.al